



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr.496/5 prot.

Tiranë, më 3.10.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 190, datë 26.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Ramiz Lala
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 18.9.2019, është njoftuar vendimi nr. 190, datë 26.7.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim z. Ramiz Lala, gjyqtar/Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastrë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 190, datë 26.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, ushtron detyrën e gjyqtarit/Kryetar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastrë dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), nga të cilat rezulton se:
 - 2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Ramiz Lala*”, ka referuar se:
 - i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - iv. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
 - v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
 - 2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*” për subjektin Ramiz Lala.
 - 2.3 **KLD**, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit z. Ramiz Lala.
3. Komisioni pas hetimit administrativ dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave lidhur me kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për secilin kriter, në mënyrë të përmbledhur, ka arritur në përfundimet si vijon:
 - 3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se [...] *subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D të aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, nuk konstatohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se, për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësisë [...].*
 - 3.2 **Për kontrollin e figurës.** Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni, në konsideratë të verifikimit e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmëri në detyrë, ka

vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

- 3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Komisioni, pasi ka analizuar shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, ka vlerësuar se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar problematikat mbi gjetjet e konstatuara, ku nga vlerësimi tërësor i tyre, sipas Komisionit, bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit, nuk vërehen rrethana që mund të ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional. Në të tilla kushte, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.
4. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, me funksion gjyqtar/Kryetar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastrë [...].*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).
6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).
7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 – 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit apo aktet e tjera që vijnë në dijeninë e tij gjatë afatit të përcaktuar në ligj për paraqitjen e ankimit.
8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, në gjendjen që janë aktet, duke vlerësuar nëse vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave në zbatim dhe të parimit të respektimit të barazisë përpara ligjit, në funksion të garantimit të një procesi të rregullt gjyqësor.
9. Në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 190, datë 26.7.2019, dhe i akteve në dosje të Komisionit, por dhe në përmbajtjen e një materiali informues/denoncues, të administruar pas marrjes së vendimit nga ana e Komisionit, vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për të vendosur mbi vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave.

10. Nisur nga roli specifik procedural, që aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 u njeh Komisionerëve Publikë, si një nga tri institucionet e përfshira në kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nënvizojmë faktin se, pas shpalljes së vendimit nr. 190/2019 të Komisionit, të shpallur në seancën publike të datës 26.7.2019, pranë Institucionit të Komisionerit Publik është administruar një material informues/denoncues.
11. Në referim të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, ky informacion, i hartuar dhe i dërguar pas marrjes së vendimit nga ana e Komisionit, i drejtohet, ndër të tjerë, dy institucioneve të rivlerësimit, përkatësisht Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe Komisionerëve Publikë. Në kuadër të identifikimit të subjektit që ka informuar drejtpërdrejt dy institucionet e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ramiz Lala, akti në fjalë nr. *** prot., është nënshkruar/vulosur nga funksionari më i lartë i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm i këtij institucioni, dhe mban datën ***.8.2019.
12. Në këtë informacion, titullari i institucionit të lartpërmendur parashton fakte dhe pretendime për mangësi profesionale dhe shkelje vijuese të ligjit, të lidhura me disa vendime gjyqësore të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastrë, në çështje të shqyrtuara prej tij, ku palë e paditur ka qenë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke cenuar rëndë, ndër të tjera, dhe buxhetin e Policisë së Shtetit.
13. Nisur nga: (i) rëndësia e fakteve dhe pretendimeve, që ky informacion përmban; (ii) pamundësia e administrimit dhe e verifikimit, si prova të vendimeve gjyqësore, nga ana e Komisionerit Publik, për shkak të pozitës së tij procedurale në proces; (iii) pamundësia e verifikimit ligjor të të gjitha ekstremiteve formale të këtyre akteve, për shkak të mosparaqitjes në formatin e plotë të kërkuar, në kopjet bashkëlidhur këtij informacioni të dërguar, çmohet nevoja që çështjet e trajtuara në këtë informacion, dhe që lidhen me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, duhet t'i nënshtrohen hetimit dhe të shqyrtohen nga Kolegji, gjatë gjykimit të këtij ankimi, në përmbushje të pikës 2, neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenit 53, të ligjit nr. 84/2016.
14. Komisioneri Publik, edhe në referencë të vlerësimit të kriterit pasuror të subjektit të rivlerësimit, çmon se hetimi i Komisionit nuk është i plotë dhe ezaurues, pasi konstatohet se pas kalimit të barrës së provës subjektit të rivlerësimit, për analizën financiare 2010-2016, për pamjaftueshmëri në deklaratimet e tij dhe administrimit të përgjigjeve të ardhura nga z. Ramiz Lala, në zbatim të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, përfundimet e arritura në vendim nga Komisioni për vlerësimin e kriterit pasuror duket se nuk gjejnë mbështetje në metodologjinë e përdorur.
15. Në të tilla rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se vendimi i Komisionit, në tërësinë e tij, ka shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, nëpërmjet një hetimi të mëtejshëm.

III. Shkaqet e ankimit

III. A Mbi nevojën e hetimit dhe të administrimit e shqyrtimit si prova të akteve të dosjeve gjyqësore, që i përkasin çështjeve gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit z. Ramiz Lala, me palë paditëse: (i) z. ***.*** dhe (ii) z. ***.***, dhe palë e paditur, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

16. Në informacionin e lartpërmendur, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, referohen dy vendime të marra nga subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, ku palë paditëse kanë qenë dy punonjës të Policisë së Shtetit, përkatësisht z. ***.*** dhe z. ***.***.

17. Në lidhje me verifikimin e ekstremiteteve formale të vendimeve që i referohet informacioni dhe përmbajtjen e tyre, rezulton se:

17.1 Për vendimin e marrë në rastin e gjykimit me palë paditëse z. ***.***, në përmbajtjen e informacionit referohen vetëm ekstremitetet formale të tij (*numri dhe data*), ndërkohë mungon në aktet bashkëlidhur versioni integral i vërtetuar i tij.

17.2 Për vendimin e marrë në rastin e gjykimit me palë paditëse z. ***.***, në përmbajtjen e vendimit referohen ekstremitetet formale të tij dhe bashkëlidhur gjendet një fotokopje e thjeshtë (*e pavërtetuar nga autoriteti zyrtar*) dhe e paplotë në tërësinë integrale të vendimit (*mungojnë disa nga faqet e tij*).

18. Komisioneri Publik, me qëllim verifikimin paraprak të ekstremiteteve formale dhe përmbajtjes integrale të këtyre akteve të përcjella në këtë informacion, në pamundësi ligjore për të kërkuar ai vetë (*Komisioneri Publik*), marrjen e provave nga institucione të treta, aksesoi dhe iu referua sot, ditën e paraqitjes së këtij ankimi (3.10.2019), përmbajtjes së portalit publik: www.gjykata.gov.al, të administruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë.

19. Në rrethanat kur referencat e këtyre vendimeve gjyqësore në ekstremitetet formale dhe përmbajtje integrale, nuk janë plotësisht të njëjta me ato të pasqyruara në informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe, për sa kohë referimi tek aktet që përmban portali publik: www.gjykata.gov.al nuk bën të mundur shkarkimin e kopjeve me vlerë ligjore të këtyre akteve, Komisioneri Publik, për efekt të hetimit nga ana e Kolegjit të këtij ankimi, parashtron nevojën e administrimit të fashikujve të plotë të gjykimit të këtyre dy çështjeve, çka do të mund të vërtetonte në formën e kërkuar nga ligji: (i) ekstremitetet formale të vendimeve; (ii) përmbajtjen e tyre dhe (iii) gjendjen e gjykimit në të cilën ato ndodhen.

20. Lidhur me pretendimin e ngritur për mungesë të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, gjatë gjykimit të çështjes gjyqësore me palë paditëse z. ***.*** dhe palë të paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, referuar akteve që përmban portali: www.gjykata.gov.al, subjekti i rivlerësimit me vendimin përkatës ka vendosur detyrimin e Drejtorisë së Policisë së Shtetit t'i njohë paditësit ***.*** gradën policore "Drejtues".

21. Në informacionin e saj, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit parashtron se argumentimi ligjor i këtij vendimi nga ana e subjektit të rivlerësimit bie në kundërshtim me ligjin dhe procedurat përkatëse, që ai parashikon në dhënien e gradave në Policinë e Shtetit.

22. Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e nenit E, të aneksit të Kushtetutës, kreut VI, “Vlerësimi i aftësisë profesionale”, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, referuar përmbajtjes së vendimit të dhënë në rastin konkret nga ana e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se ka vend për të hetuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit në lidhje me elemente të tilla si: (i) aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin; (ii) aftësia për të identifikuar konfliktin e normave; (iii) aftësia për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe (iv) aftësia për të analizuar jurisprudencën.
- 22.1 Referuar vendimit në çështjen gjyqësore me palë paditëse z. ***.***, në atë kohë (*në momentin e paraqitjes së padisë*) mbajtës i gradës “Kryekomisar” dhe ushtrues i detyrës Shef i Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, në përfundim të gjykimit, ka vendosur dhënien e gradës “Drejtues”, mbi bazën e kërimit të palës paditëse, i cili e ka mbështetur këtë kërkim vetëm në pretendimin se plotëson vjetërsinë e kërkuar për marrjen e gradës dhe ushtron një detyrë për të cilën kërkohet mbajtja e gradës “Drejtues”.
- 22.2 Ndërkohë konstatohet se, sikundër parashtrohet dhe në informacionin e përcjellë në Institucionin e Komisionerëve Publikë, ligji i zbatueshëm, që rregullon sistemin e gradave në Policinë e Shtetit në Republikën e Shqipërisë, është ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Kreu VIII i këtij ligji, “Gradat” (*nenet 50-62*), rregullon në mënyrë të detajuar: (i) sistemin e gradave; (ii) procedurat administrative që ndiqen për fitimin e gradës; (iii) kriteret që duhen plotësuar nga kandidatët për marrjen e gradave; (iv) arsimimin; (v) kryerjen e procesit të konkurrimit dhe (vi) procesin të ankimit administrativ.
- 22.3 Komisioneri Publik vëren se, referuar nevojës së verifikimit të elementeve që bëjnë të matshëm vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala (*aftësia për të interpretuar ligjin*), për sa parashtrohet në pjesën arsyetuese të aktit konkret (*vendimit gjyqësor*) grada “Drejtues” duket se i është dhënë palës paditëse, z. ***.***, me vendim gjyqësor, pa kryer analizën ligjore të kryerjes paraprakisht së procedurave administrative, të parashikuara hollësisht në ligjin nr. 108/2014, të ndryshuar, si *conditio sine qua non* për fitimin e gradës, të tilla si: (i) nxjerrja e urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm për fillimin e procedurave konkurruese për një numër të kufizuar të vendeve të lira për gradën “Drejtues” për vitin respektiv (*neni 54*), (ii) verifikimi i kandidatëve konkurrues (*neni 56*); (iii) kryerja e testimit (*neni 57*) dhe (iv) ndjekja eventuale e procedurave të ankimit administrativ (*neni 60*). Vetëm pasi të ndiqeshin dhe ezauroheshin të gjitha këto procedura administrative që ligji ka parashikuar në mënyrë specifike, palës paditëse do t’i lindte eventualisht e drejta për t’iu drejtuar juridiksionit gjyqësor.
23. Lidhur me pretendimin e ngritur për mungesë të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, gjatë gjykimit të çështjes gjyqësore me palë paditëse z. ***.*** dhe palë të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, referuar akteve që përmban portali: www.gjykata.gov.al, administruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit me vendimin përkatës ka vendosur: [...] (i) *Shfuqizimin e urdhrin nr.***, të datës ***.1.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit*; (ii)

*Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i njohë z. ***.*** gradën policore “Drejtues i Parë”, nga data ***.12.2007 e në vazhdim; (iii) Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i paguajë z. ***.*** pagën si Drejtues i Parë nga data ***.7.2008 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon sipas gradës policore Drejtues i Parë; (iv) Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i njohë dhe paguajë z. ***.*** vjetërsinë në punë si Drejtues i Parë nga data ***.12.2007 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon sipas gradës policore Drejtues i Parë; (v) Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i paguajë z. ***.*** sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe sigurimet suplementare në bazë të pagës që i korrespondon si Drejtues i Parë nga data ***.12.2007 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon sipas gradës policore Drejtues i Parë; (vi) Vendimi i gjykatës të jepet në ekzekutim të përkohshëm dhe të menjëhershëm për të drejtat e përfituara nga subjekti nëpërmjet vendimit gjyqësor [...].*

24. Në informacionin e përcjellë pranë Komisionerëve Publikë, duke iu referuar kësaj vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit pretendon se mungesa e aftësisë profesionale në dhënien e këtij vendimi nga ana e subjektit është e tillë që ka sjellë si pasojë cenimin e rëndë të buxhetit të Policisë së Shtetit dhe imazhit të saj.
25. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, referuar elementeve me të cilat matet aftësia profesionale e magjistratit gjyqtar gjatë procesit të rivlerësimit, pretendon: (i) mungesën e aftësisë për të interpretuar ligjin dhe (ii) mungesën e aftësisë për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës, sa kohë vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka disponuar mbi kërkime të palës, që përbëjnë gjë të gjykuar dhe është disponuar për vënien e vendimit në ekzekutim të menjëhershëm, pa pasur një kërkim të tillë nga pala paditëse.
26. Nga përmbajtja e akteve të konsultuara në portalin: www.gjykata.gov.al, administruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, rezulton se pala paditëse, në gjykimin e lartpërmendur, z. ***.***, ka mbajtur gradën “Kryekomisar” dhe kryente detyrën e Drejtorit të Qendrës së Studimeve të Kualifikimit në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”, në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- 26.1 Me urdhrin nr. ***, datë ***.9.2006, të zëvendësministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. ***.*** është caktuar në një pozicion më të ulët në detyrë, brenda së njëjtës strukturë, konkretisht përgjegjës i Seksionit të Formimit të Rolit Bazë. Me urdhrin nr. ***, datë ***.9.2006, të zëvendësministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i është caktuar grada “Nënkomisar”, për shkak të mospërputhjes së gradës policore me funksionin organik, duke iu ulur edhe paga mujore.
- 26.2 Z. ***.*** i ka kundërshtuar gjyqësisht urdhrat e mësipërm të dhënë nga zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke thirrur në gjykim si palë të tretë Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Me vendimin nr. ***, datë ***.12.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se ka vendosur: (i) shpalljen si të pavlefshëm të urdhrin nr. ***, datë ***.9.2006 dhe urdhrin nr. ***, datë ***.9.2006; (ii) detyrimin e të paditurit të rivendosë

- të drejtat e cenuara në funksionin e mëparshëm si rezultat i pavlefshmërisë së akteve dhe (iii) detyrimin e të paditurit të paguajë pagën prej 85.470 lekësh në muaj, që i përket gradës “Kryekomisar”, [...]... *duke filluar që nga data ***.9.2006 e në vazhdim* [...].
- 26.3 Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykuar në të gjitha shkallët e gjykimit dhe është kthyer në vendim të formës së prerë të ekzekutueshëm, pasi është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë ***.4.2012, *me ndryshimin: [...] detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit pagën prej 85.470 lekësh në muaj, që i përket gradës “Kryekomisar”, për një vit.* [...]
- 26.4 Rezulton se z. ***.*** i është drejtuar shërbimit përmbartimor gjyqësor privat për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Me vendimin nr. *** akti, datë ***.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit të mësipërm nr. ***, datë ***.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nga aktet, konstatohet të ketë shlyer detyrimin në lidhje pagesën e vlerës së një viti të pagës, që i përket gradës përkatëse, sipas vendimit gjyqësor.
- 26.5 Në vijim, pas kërkesës së z. ***.***, i cili pretendonte cenim të procesit të rregullt gjyqësor, sa kohë nuk zbatohet plotësisht vendimi gjyqësor i formës së prerë (*për sa i takon rivendosjes së të drejtave të cenuara në funksionin që ai kishte kryer*), Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. ***, datë ***.11.2015, ka konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. ***, datë ***.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kthimin e gradës dhe ushtrimin e detyrës.
- 26.6 Nga aktet, duket se z. ***.*** është rikthyer në detyrë në Policinë e Shtetit, me urdhrin nr. ***, datë ***.3.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, urdhër të cilin, z. ***.*** e ka kundërshtuar sërish në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, Tiranë, pasi e ka konsideruar si të nxjerrë në shkelje të hapur të ligjit, duke kërkuar njëkohësisht dhe nxjerrjen e të gjitha akteve që kanë të bëjnë me përfitimin e gradës dhe trajtimin financiar përkatës (*pagë, vjetërsi, sigurime shoqërore etj.*). Gjykata e Shkallës së Parë Administrative, Tiranë, duket se ka vendosur të konstatojë pavlefshmërinë e urdhrin nr. ***, datë ***.3.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe njohjen e detyrimit për zbatimin e vendimit të formës së prerë nr. ***, datë ***.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke rrëzuar padinë për kërkimet e tjera.
- 26.7 Po ashtu, nga informacioni i DPPSH-së, rezulton se z. ***.***, së bashku me shoqërinë private përmbartimore, në cilësinë e ndërhyrësit kryesor, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë me një tjetër padi, duke pretenduar shpërbllimin e dëmit pasuror dhe jopasuror (moral), ardhur si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe konflikteve gjyqësore, dhe kallëzimeve penale mes palëve, në fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

- 26.8 Dëmi pasuror, i pretenduar nga z. *****.***** për t' u paguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, përfaqësonte vlerën e pagës që ai duhet të merrte pas ekuivalentimit të gradës “Kryekomisar” me gradën “Drejtues”, gjithsej për një vlerë 15.072.204 lekë.
- 26.9 Pas gjykimit të kësaj padie, rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë ka vendosur: [...] **1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. 2. Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit që, solidarisht të paguajë në favor të paditësit, *****.***, dëmin jopasuror në vlerën 9.487.258 lekë. 3. Rrëzimin e kërimit të paditësit *****.*** për shpërblimin e dëmit pasuror në masën 15.072.204 lekë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. 4. Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit që, solidarisht, të paguajë në favor të paditësit, Shoqëria Përmbaramore Gjyqësore Private “***” sh.p.k., dëmin jopasuror, në vlerën totale 11.321.891 lekë. 5. Pranimin e kërkesëpadisë së ndërhyrësve kryesorë. 6. Detyrimin e Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit që, solidarisht, të paguajë në favor të ndërhyrësve kryesorë, *****.*** bashkëshortja e paditësit, *****.*** dhe *****.***, fëmijët e paditësit, dëmin jopasuror në vlerën 6.281.550 lekë [...].************
- 26.10 Me urdhrin nr. *******, datë *****.1.2019**, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është vendosur transferimi i z. *****.***** dhe emërimi në detyrë Shef Sektori në Sektorin për Migracionin, në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, në Gjirokastrë.
- 26.11 Për këtë urdhër, z. *****.***** i është drejtuar sërish juridiksionit gjyqësor, kësaj radhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastrë, me padi me objekt: (i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin nr. *******, datë *****.1.2019**, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; (ii) detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të nxjerrë aktet ligjore në zbatim të urdhërimeve të vendimit nr. *******, datë *****.12.2006**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. *******, datë *****.11.2015**.
- 26.12 Sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe konsultimit të përmbajtjes së akteve të konsultuara në portalin: www.gjykata.gov.al, administruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, në përfundim të gjykimit ka vendosur: [...] (i) *Shfuqizimin e urdhrin nr. *******, të datës *****.1.2019**, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;* (ii) *Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i njohë z. *****.*** gradën policore Drejtues i Parë nga data *****.12.2007** e në vazhdim;*** (iii) *Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i paguajë z. *****.*** pagën si Drejtues i Parë nga data *****.7.2008** e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon sipas gradës policore Drejtues i Parë;*** (iv) *Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i njohë dhe paguajë z. *****.*** sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe sigurimet suplementare dhe vjetërsinë në punë si Drejtues i Parë nga data *****.12.2007** e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon sipas gradës policore Drejtues i Parë;*** (v) *Vendimi i gjykatës të jepet në ekzekutim të përkohshëm dhe të menjëhershëm për të drejtat e përfituara nga subjekti nëpërmjet vendimit gjyqësor.*

- 26.13 Në informacionin e përcjellë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, vendimi i mësipërm referohet si një vendim që është dhënë si pasojë e mungesës së aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke e konsideruar si të marrë në kundërshtim me ligjin, pasi: (i) ka disponuar përtej objektit të padisë; (ii) ka disponuar mbi një kërkim që përbën gjë të gjykuar (*përfitimi i pagës*) dhe (iii) ka disponuar vënien në ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit, pa pasur kërkim të tillë nga pala paditëse.
27. Komisioneri Publik vëren se, referuar nevojës së verifikimit të elementeve që bëjnë të matshme vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, të tilla si: (i) *aftësia për të interpretuar ligjin*; (ii) *aftësia për identifikimin e konfliktit të normave*; (iii) *aftësia për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës* dhe (iv) *aftësia për të analizuar jurisprudencën*, për sa parashtrohet në pjesën arsyetuese të aktit konkret, vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit duket se disponon (*dhënien e gradës, pagesën e pagës dhe përfitimeve të tjera financiare nga data ***.7.2008*) mbi objektin e një konflikti gjyqësor, që është zgjidhur më parë nga juridiksioni gjyqësor me një vendim të formës së prerë, si dhe ka disponuar për vënien në ekzekutim të menjëhershëm të vendimit gjyqësor, ndër të tjera, për një shumë të konsiderueshme monetare (*pagesa e pagës dhe përfitimeve të tjera financiare nga data ***.7.2008, në masën 15.072.204 lekë, referuar gjykimeve të mëparshme*), përtej kërtimeve të palës paditëse.
28. Komisioneri Publik çmon të nevojshme të theksojë se qëllimi i procesit të rivlerësimit, shprehur në nenin 179/b të Kushtetutës dhe në nenin 1, të ligjit nr. 84/2016, është garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
29. Konfirmimi eventualisht i mungesës së aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit në raport me kriteret e rivlerësimit, të përcaktuara në aneksin e Kushtetutës dhe në ligj, pas hetimit të shkaqeve të këtij ankimi nga Kolegji, duke pasur në konsideratë po ashtu faktin se vetë Komisioni, në mungesë të mundësisë për të administruar e gjykuar mbi informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*për shkak se u paraqit pas dhënies së vendimit*), e ka konfirmuar atë (subjektin e rivlerësimit), vetëm me një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, do të cenonte besimin që duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit/rolit të gjyqtarit në dhënien e drejtësisë.

III.B Për kriterin e pasurisë. *Nevoja e hetimit mbi përfundimet e arritura për pamjaftueshmërinë e konstatuar për periudhën 2010-2016, lidhur me mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e deklaruar.*

30. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, ka qenë mbartës i detyrimit për deklarim periodik të interesave pasurore në ILDKPKI për herë të parë në vitin 2010. Pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e z. Ramiz Lala janë deklaruar në Deklaratën e personit, që mbart detyrimin për deklarim pasurie (këtu e në vijim referuar si DV), në deklaratat periodike për vitet 2010 - 2016, dhe në Deklaratën “Vetting”, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 27.1.2017.
31. Rezulton se Komisioni nga shqyrtimi i vetëdeklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe i dokumentacionit ligjor të administruar në dosje, ka kryer analizën financiare për të gjithë

periudhën e deklarimit nga subjekti, vitet 2010-2016. Nga analiza financiare paraprake, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të [...] *nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe mbulimin e shpenzimeve për jetesë, arredim, transport, qira dhe shkollim, të deklaruar për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, me një diferencë negative që në total është në vlerën - 1.235.304 lekë [...].*

- 31.1 Lidhur me këtë fakt, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës¹ për të dhënë argumentet dhe provat në lidhje me konstatimet e bëra, për sa i përket kriterit të pasurisë.
- 31.2 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, lidhur me analizën financiare, ka kërkuar që nga ana e Komisionit të rivlerësohen të dhënat, duke pretenduar se: (i) *“pagesa, shpenzime jetese familja”* është llogaritur si shpenzime jetese familje për 6 persona, në 22 ditë të çdo muaji, ndërkohë familja përbëhet me 5 pjesëtarë²; (ii) në shpenzimet e jetesës familjare, të zbriten vlera e përfitimit në natyrë të perimeve dhe zarzavateve, të përfituara nga bashkëshortja e tij, nga përdorimi i tokës bujqësore në pronësinë e subjektit në ***, Tiranë; (iii) te zëri të ardhurave të bashkëshortes të vitit 2014, të shtohet shuma prej 45.000 lekësh, e përfituar nga bashkëshortja nga DAR Tiranë; (iv) te zëri shpenzime udhëtime dhe pushime për vitin 2014, vlera duhet të jetë 22.260 lekë³; (v) te zëri shpenzime udhëtime dhe pushime për vitin 2015, vlera duhet të jetë 50.000 lekë dhe jo 126.980 lekë; (vi) është kryer përlllogaritje jo e saktë e lëvizjeve të llogarive bankare në emër të bashkëshortes së subjektit për vitin 2015; si dhe (vi) shpërndarjen e shpenzimeve të mobilimit për vitet 2011 dhe 2012.
- 31.3 Pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka vlerësuar dhe marrë në konsideratë, në analizën financiare, shpjegimet e subjektit që kanë të bëjnë me: (i) shtesën e të ardhurave për vitin 2014, të përfituara nga bashkëshortja e subjektit nga DAR Tiranë; si dhe (ii) uljen e shpenzimeve për vitin 2014, dhe konkretisht te zëri i shpenzimeve për udhëtime dhe pushime⁴.
- 31.4 Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje, Komisioni ka vërejtur se në llogaritë e subjektit të rivlerësimit, në *** Bank⁵ dhe ***⁶ janë kredituar për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, vlera monetare që përfaqësojnë dieta të përfituara nga subjekti i rivlerësimit, që në total janë në shumën 486.372 lekë.
- 31.5 Në këto rrethana, Komisioni, në vendimin e tij, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *Në vlerësim të të dhënave të mësipërme, faktit se këto të ardhura nga dietat nuk janë evidentuar më parë në analizën financiare, si dhe faktit se dietat në vetvete përfaqësojnë shpenzime të mundshme*

¹ Referohuni aktit “Rezultatet e hetimit administrativ”, f. 13-14, në dosje të Komisionit.

² Subjekti ka pretenduar se në shpenzime jetese janë llogaritur njëkohësisht shpenzime jetese të kryera nga subjekti në Përmet, Gjirokastrë, si dhe shpenzime jetese të kryera nga subjekti në Tiranë, së bashku me familjen për 22 ditë të çdo muaji. Nisur nga ky pretendim, subjekti ka kërkuar që në zërin *“pagesë shpenzime dhe transport”* duhet të vendosen vetëm shpenzimet për transport dhe të zerohen shpenzimet e jetesës të kryera nga subjekti në Përmet dhe Gjirokastrë.

³ Kjo vlerë i është referuar vërtetimit, datë ***.7.2019, të Agjencisë turistike “***.***.***”, vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit.

⁴ Referohuni f. 23 të vendimit të Komisionit.

⁵ Referohuni dokumentacionit të përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2019, të ***-së.

⁶ Referohuni dokumentacionit të përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2019 të ***-së.

për udhëtim, fjetje dhe ushqim, të kryera nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se në analizën financiare të zbriten shpenzimet e llogaritura më vete për subjektin e rivlerësimit për këto zëra (ushqim, transport dhe fjetje)⁷ [...].

- 31.6 Pas reflektimit të të dhënave të reja, siç duket, mbi bazën e arsytimit të mësipërm, Komisioni ka ardhur në përfundimin se: [...]...*Nga shqyrtimi i vetëdeklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit ligjor të administruar në dosje duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve për vitet 2014 dhe 2016, vite të cilat paraqiten me balancë negative të fondeve në total për vlerën – 88.286 lekë [...].*
32. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në vendimin e tij, Komisioni nuk jep argumente të bazuara në kërkesat e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe jurisprudencën e Kolegjit, duke rezultuar i paqartë shkaku se pse është ndjekur një metodologji e caktuar, e ndryshme, për kryerjen e analizës financiare, pas kalimit të barrës së provës subjektit të rivlerësimit, metodologji kjo që ka ndikuar në reduktimin e një balancë negative të të ardhurave të ligjshme nga një vlerë -1.235.304 lekë, në një balancë negative në vlerën - 88.286 lekë.
- 32.1 Nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, duket se në analizën financiare përfundimtare, është reduktuar krejtësisht: (i) zëri “pagesë shpenzime dhe transport (Përmet dhe Gjirokastër)”, si dhe (ii) zëri “pagesë shpenzime qiraje” për vitet e analizuar⁸. Nisur nga pretendimet e subjektit në parashtrimet përfundimtare rezulton se reduktimi i këtyre dy zërave të shpenzimeve është në tejkalim dhe të vetë pretendimeve të subjektit⁹.
- 32.2 Gjithashtu, në vlerësimin e Komisionerit Publik, mbetet e paqartë pse në analizën financiare të kryer nga Komisioni janë zbritur shpenzimet e llogaritura për subjektin e rivlerësimit (*për zërat ushqim, transport dhe fjetje*), duke marrë në konsideratë vlerat monetare të dietave të kredituara në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit. Nga aktet në dosje, konstatohet se vlerat e shpenzimeve të zbritura nga Komisioni, përveç se janë në tejkalim të pretendimeve të vetë subjektit, janë në tejkalim edhe të vlerave të dietave të kredituara në llogaritë bankare të tij.
- 32.3 Për sa më sipër, Komisioneri Publik kërkon që nga ana e Kolegjit të rivlerësohen zërat e analizës financiare për periudhën 2010-2016, ku subjekti ka rezultuar me balancë negative dhe në varësi të rezultatit të konkludojë mbi mundësinë financiare të subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme të ardhurat e deklaruara dhe shpenzimet e kryera.

IV. Kërkimi i ankimit

33. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve

⁷ Referohuni f. 24, paragrafi 61.3 i vendimit të Komisionit.

⁸ Referohuni analizës së Komisionit, në f. 24 të vendimit.

⁹ Subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, nuk ka pretenduar reduktimin e shpenzimeve të transportit dhe të shpenzimeve të qirasë, shpenzime të vetëdeklaruara prej tij.

të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

- 34.** Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b/5, të Kushtetutës, neneve C/2, Ç, dhe F/7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në vendimin nr. 190, datë 26.7.2019, referuar gjendjes së fakteve, provave dhe informacionit të administruar, referuar nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se gjen zbatim neni 59/1, i ligjit nr. 84/2016;
- 35.** Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave, për subjektin e rivlerësimit, z. Ramiz Lala, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:
- Ndryshimin
ose
 - Lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 26.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

* Bashkëlidhur shkresa (informacioni) nr. *** prot., datë ***.8.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.



KOMISIONERËT PUBLIKË
Nr. 427 Prot.
Datë 02.08.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. ___ Prot.

Numri i kopjeve 2
Afati i ruajtjes 10
Tiranë, më, ___ .08.2019

Lënda: Dërgojmë informacion mbi shkeljet e kryera nga gjyqtari Ramiz Lala

Drejtuar: KËSHILLIT TË LARTË TË GJYQSORIT
KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIT
KOMISIONERIT PUBLIK

Për dijeni: MINISTRISË SË DREJTËSISË

TIRANË

Të nderuar,

Duke marrë shkas nga disa vendime gjyqësore të dhëna në vlerësimin tonë në kundërshtim të plotë me ligjin dhe zbatimin e tij, gjyqtari **Ramiz Lala**, aktualisht kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, ndaj të cilit kemi evidentuar edhe me parë shkelje periodike të ligjit nga ana e tij, Ju drejtohem shkresërisht pasi dhënia e këtyre vendimeve gjyqësore, të pambështetura në ligj dhe në mënyrë arbitrare nga Z.Lala, kanë sjellë ndaj institucionit tonë dëme të parikuperueshme dhe që vazhdojnë t'a çënojnë atë.

Shkeljet e përsëritura të gjyqtarit Ramiz Lala, janë evidentuar edhe përmes vendimit nr. ___ datë ___ 05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, e cila ka disponuar me :

- Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë;
- Shfuqizimin e urdhrin Nr. ___, datë ___ .01.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit "Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie";

- Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i njohë paditësit gradën policore Drejtues i Parë nga data ...12.2007 e në vazhdim.
- Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i paguajë paditësit pagën si Drejtues i Parë, nga data ...07.2008 e në vazhdim deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i Parë;
- Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i njohë dhe paguajë paditësit vjetërsinë në punë si Drejtues i Parë nga data ... 12.2007 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i Parë;
- Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i paguajë paditësit sigurimet shoqërore dhe shëndetsore si dhe sigurimet suplementare në bazë të pagës që i korrespondon gradës policore Drejtues i Parë nga data ... 12.2007 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i Parë;
- Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të objektit të saj;
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- **Vendimi i gjykatës përbën titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor në mënyrë të menjëhershme dhe të përkohshme për të drejtat e përfituara nga subjekti paditës nëpërmjet këtij vendimi gjyqësor nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqëse.**
- Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, Brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar;

Në këndvështrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, vendimi i sipërcituar i gjykatës është në kundërshtim me ligjin, pasi në objektin e padisë kërkohet shfuqizimi i urdhërit të transferimit të paditësit , ndërkohë në dispozitivin e vendimit gjyqësor paditësit i akordohet dhënia e gradës policore "*Drejtues i Parë*", përfshire efektet financiare dhe kontributet e sigurimeve shoqërore që nga viti 2007 dhe deri me sot.

Absurditeti në vendimarrje i gjyqtarit Ramiz Lala, pasqyrohet në pikën 9, të dispozitivit të vendimit "**Vendimi i gjykatës përbën titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor në mënyrë të menjëhershme dhe të përkohshme për të drejtat e përfituara nga subjekti paditës nëpërmjet këtij vendimi gjyqësor nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqëse**".

Dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm është bërë me iniciativën e gjyqtarit dhe pa u kërkuar nga pala paditëse në proces gjyqësor, gjë që ka sjellë shkelje flgrante të dispozitave procedurale të Kodit të Procedurës Civile.

Duke qënë se në vijim, konstatojmë sërish vendime gjyqësore ku palë e paditur është Policia e Shtetit, vendimet gjyqësore të dhëna nga ky gjyqtar kanë sjellë problematika të vazhdueshme. Konkretisht, sjellim në vëmendje disa vendime gjyqësore të cilat kanë rënduar imazhin e Policisë së Shtetit si dhe kanë rënduar buxhetin e saj, me paligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë si objekt shqyrtimi, dhënien e gradave punonjësve të policisë së shtetit, në kundërshtim me ligjin organik të Policisë së Shtetit i cili ka sanksionuar fitmin e gradës policore, kriteret e përfitimit të gradës dhe kategoritë e saj. Ndërkohë që sipas vendimeve gjyqësore të dhëna nga ky gjyqtar punonjësit e policisë kanë fituar grada policore duke anashkaluar / injoruar ligjin dhe zbatimin e tij dhe janë dhënë nëpërmjet procesit gjyqësor.

Veçojmë vendimin gjyqësor nr. *** datë 03.03.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, dhënë në favor të paditësit *** me argumentin se: " *** është Përgjegjës Sektori dhe eprori i drejtëpërdrejtë, Drejtori i DVP – së, ka gradën "Drejtues i Parë ", për rrjedhojë, Z. *** duhet ti akordohet grada "Drejtues".

Një argument i tillë i gjyqarit Ramiz Lala është totalisht i kundraligjshëm, pasi ngritja nga një gradë me e ulët në një gradë më të lartë, është e lidhur, së pari, me ekzistencën e vendeve të lira në atë gradë, së dyti, me plotësimin e kushtit të vjetërsisë së qëndrimit në gradën e mëparshme, i cili përbën një kriter kualifikues për tu futur në konkurs nga ana e punonjësit kandidues dhe, së treti, pas përfundimit me sukses të trajnimit për gradën më të lartë.

Sistemi i gradave në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", është i lidhur me funksionin dhe nuk është një sistem që i jep automatikisht të drejtën për të përfituar gradën superiore të gjithë atyre që plotësojnë kriteret e vjetërsisë. Përcaktimi i numrit të mbajtësve të një grade të caktuar, pra i numrit të funksioneve korresponduese, bëhet në përputhje me politikat e rendit dhe sigurisë, si pjesë e politikave ekzekutive të shtetit.

Në këtë kuadër, pushteti gjyqësor nuk ka juridiksion për të verifikuar përshtatshmërinë apo dobishmërinë e politikave në këtë fushë, pasi kjo i përket sferës së pushtetit ekzekutiv. Mbështetur në parimin e ndarjes së pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, zgjidhjet që i takojnë kompetencës ekskluzive të një pushteti, nuk mund të përbëjnë lëndë të shqyrtimit nga pushtetet e tjera.

Në këtë kontekst, fusha e përcaktimit të gradave dhe funksioneve që i korrespondojnë atyre, është një fushë që i përket diskrecionit të pushtetit ekzekutiv dhe për mbarëvajtjen në tërësi të politikave në fushën e rendit dhe të sigurisë, ashtu si edhe në fusha të tjera, ai përgjigjet përpara pushtetit legjislativ që e ka votëbesuar.

Në këto çështje, roli i gjykatës kufizohet vetëm në ato raste kur nga ana e organeve kompetente janë shkelur kriteret e vendosura me ligj në raport me një kandidat, si pasojë e së cilës atij i është cenuar e drejta për të avancuar në karrierë. Pra, gjykata mund të investohet vetëm nëse një kandidat padrejhtësisht është përjashtuar nga konkurrimi i shpallur, nuk është renditur në vendin e merituar ose nuk i është dhënë grada pasi ka përfunduar me sukses trajnimin për vendet e shpallura. Nga ana tjetër, gjykata nuk mund të detyrojë organet ligjzbatuese për të shpallur një konkurrim, për të shtuar numrin e vendeve ose funksioneve korresponduese për një gradë apo për të dhënë grada më tepër se c'janë vendet e punës për ato grada.

Së fundmi, hasim në vendime gjyqësore të pakuptueshme, të dhëna në kundërshtim me ligjin, duke na sjellë një kaos në zbatimin e tyre. Konkretisht ju sjellim përpara një problematikë të vazhdueshme që lidhet gjithashtu edhe me veprimet arbitrare të përmbauesit Z. *** (ndaj të cilit kemi bërë edhe kallëzim penal për shpërdorim detyre, por sërish gjykata nuk e ka marrë në konsideratë), duke na krijuar mendimin se këto instrumenta ligjorë të përdorur janë keqinterpretuar nga institucione të caktuara ndër vite, Ju sqarojmë sa vijon:

Paditësi ****, punonjës i policisë së shtetit, i cili pasi ka ngritur disa kërkesë padi me objekte të ndryshme, drejtuar si Gjykatës së Rrethit Tiranë, më pas asaj Administrative Tiranë, gjykuar nga Z. **** më pas i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, ku gjyqtari Ramiz Lala, është shprehur me vendimin gjyqësor Nr. ** datë ** 05.2019, në kundërshtim të plotë me ligjin, duke tejkalluar objektin e kërkesë padisë, duke u shprehur për një gjë të gjykuar dhe shumë e shumë shkelje të tjera, për të cilat do të luteshim të merreshin parasysh, gjatë procesit të verifikimit të figurës dhe anës profesionale të këtij gjyqtari.

Ju sjellim në vëmendje se gjyqtari Ramiz Lala, në disa praktika gjyqësore, u ka dhënë të drejtë palëve paditëse duke fituar njëkohësisht dy grada policore. Gjithashtu rezultoi e provuar se disa punonjës policie me vendbanim dhe ushtrim detyre në Tiranë, u është pranuar kërkesë padia nga gjyqtari në fjalë në kundërshtim me kompetencën toksore të gjykatës.

Për të mos rënë në përsëritje, Ju bashkëlidhim vendimet gjyqësore të cilat i mendojmë se shfaqin shkelje ligjore të dukshme dhe jo pa qëllim, duke shprehur në vlerësimin Tuaj dhe mbështetjen, si dhe për të tërhequr vëmendjen ndaj përmbartës gjyqësor privat Z. **** i cili sistematikisht dërgon në institucionin tonë urdhra ekzekutimi, të cilave thjesht ju ndërron datën dhe përmbajtja e tyre, s'ka asnjë mbështetje ligjore, me bindjen se pretendimet tona do të dëgjohen, mirëpresim çdo vlerësim Tuajin mbi këtë problematikë.

Ju informojmë gjithashtu që nga ana e institucionit tonë, për rastin ****, gjykuar fillimisht nga Z. **** dhe Z. Ramiz Lala, i jemi drejtuar gjykatës kompetente me kërkesën "Për kundërshtim të veprimeve përmbartimore", pasi objekti i shqyrtimit dhe dispozitivi i vendosur bie në kundërshtim me ligjin.

Mbështetur në faktet juridike, praktikën bashkëlidhur dhe argumentimin e parashtruar sa më sipër, duke qenë të vendosur për një zgjidhje të drejtë mbi këto raste të cilat janë haptazi antiligjore nga ana e këtij gjyqtari, kërkojmë që në përputhje me autoritetin që ju njeh ligji, të merrni në konsideratë gjithë sa më sipër, duke verifikuar paligjshmërinë e vendimmarrjes së tyre dhe më pas marrjen e masave konkrete për këtë gjyqtar.

(Bashkëlidhur, për njohje të detajuar, gjendet praktika e plotë dokumentare mbi këto çështje).

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Drejtues Madhor Ardi VELIU



Adresa: Bulevardi "Bajram CURRI" Tel./Fax. 00355 4 2 25370 www.asp.gov.al



Nyrtia Bushkriote Nr. 9,
Rruga "Skënderbeu",
Pall. 70, Kat. 2, Zyra Nr. 2,
Tirana, Albania
Tel/Fax: +355 41 252 888
www.shh.kj



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E POLICISË SË SHQETIT

Nr. ... _Prot. ...
Datë ... 06.2019

Data: e hënë, 2019-06-17

Nr. ... _Prot. ...
Llogja Nr. ...

**LAJMËRIM
PËR EKZEKUTIM VULLNETAR**

Drejtuar Debitorit: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me adresë:
Bulevardi: "Bajram Curri", 1000, Tiranë;

Për dijëni: **Ministria e Brendshme**, me adresë: Sheshi "Skënderbej", Nr. 3,
Tiranë;

Për Dijëni Kreditorit: ... i biri i ... dhe ... shtetas shqiptarë, lindur më
... 08.1969, në Dibër, i identifikuar nga letërnjoftimi me numër
personal ... dhe me adresë: Rruga " ...",
banesë private, Tiranë.

Unë, ... përmbaues gjyqësor privat pranë shoqërisë përmbaimore gjyqësore private
... Sh.p.k. ("..."), pasi studiova materialet e dosjes përmbaimore Nr. ... bazuar në
Vendimin Nr. ... datë ... 05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrër,

KONSTATOVA:


Se më datë ... 06.2019 është depozituar pranë ... kërkesa e ... i biri i ... dhe ...
shtetas shqiptarë, lindur më ... 08.1969, në Dibër, i identifikuar nga letërnjoftimi me numër
personal ... dhe me adresë: Rruga ... banesë private, Tiranë, pas disa
seancave gjyqësore të zhvilluara dhe të konkretizuara sa me poshtë vijon:

1. Vendimit Nr. ... datë ... 05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë
Gjirokastrër, i cili vendosi:

1. "Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.
2. Shfuqizimin e aktit administrativ, urdhërit Nr. ... datë ... 01.2019 të Drejtorisë së
Përgjithshme të Policisë së Shtetit "Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie".
- ... 3. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i njohë paditësit
gradën policore Drejtues i I-rë nga data ... 12.2007 e në vazhdim.
4. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i paguajë
paditësit ... pagën e pamarrë si Drejtues i I-rë nga data ... 07.2008 e në vazhdim, deri në
sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i I-rë.
5. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i njohë dhe
paguajë paditësit ... vjetërsinë në punë si drejtues i I-rë nga data ... 12.2007 e në vazhdim,
deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i I-rë.
6. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i paguajë
paditësit ... sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe sigurimin suplementar në bazë të
pagës që i korrespondon gradës policore Drejtues i I-rë nga data ... 12.2007 e në vazhdim, deri në
sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i I-rë.
7. Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të objektit të saj.
8. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së
Shtetit.

9. Vendimi i gjykatës përbën titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm nga përmbauesi
gjyqësor në mënyrë të menjëhershme dhe të përkohshme për të drejtat e përfituara nga subjekti paditës
nëpërmjet këtij vendimi gjyqësor nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqësore.

10. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15
ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.



U shpall në Gjirokastrë, sot më datë *** 05.2019.

Shpenzime gjyqësore

Taksë regjistrimi kërkesë padie 3000 Lekë
Shpenzime për Njoftime 7 njoftime x 120 = 840 Lekë
Gjithësej 3.840 Lekë*


Sa më sipër, në mbështetje të neneve 517, 518, 525 të Kodit të Procedurës Civile, dhe Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar,

LAJMËROJ:

1. Palën debitore Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me adresë: Bulevardi: "Bajram Curri", 1000, Tiranë, të bëjë ekzekutimin vullnetar brenda **10 (dhjetë) ditësh** (pavarësisht që ky vendim është në vazhdim të ekuilibrit dhe konfliktit gjyqësor për marrëdhëniet e punës në lidhje me aktet administrative që janë shpallur të pavlefshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë gjetur kjo dhe sipas arsyetimit të bërë në faqen 20, paragrafi i dytë, të vendimit Nr. *** datë *** 05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë) nga dita e marrjes dijeni të detyrimit ndaj palës kreditore *** duke vepruar sipas Vendimit Nr. *** datë *** 05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, i cili vendosi:

1. "Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.
2. Shfuqizimin e aktit administrativ, urdhërit Nr. *** datë *** 01.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit "Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie".
3. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i njohë paditësit *** gradën policore Drejtues i I-rë nga data *** 12.2007 e në vazhdim.
4. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i paguajë paditësit *** pagën e pamarrë si Drejtues i I-rë nga data *** 07.2008 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i I-rë.
5. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i njohë dhe paguajë paditësit *** vjetërsinë në punë si drejtues i I-rë nga data *** 12.2007 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i I-rë.
6. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, t'i paguajë paditësit *** sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe sigurimin suplementar në bazë të pagës që i korrespondon gradës policore Drejtues i I-rë nga data *** 12.2007 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i I-rë.
7. Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të objektit të saj.
8. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
9. **Vendimi i gjykatës përbën titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor në mënyrë të menjëhershme dhe të përkohshme për të drejtat e përfituara nga subjekti paditës nëpërmjet këtij vendimi gjyqësor nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqësore.**

10) Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmyja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. U shpall në Gjirokastrë, sot më datë *** 05.2019.



Shpenzime gjyqësore

Taksë regjistrimi kërkesë padie 3000 Lekë
Shpenzime për Njoftime 7 njoftime x 120 = 840 Lekë
Gjithësej 3.840 Lekë"

Sa më sipër, bazuar në Vendimin e sipërcituar, debitori, **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**, i detyrohet kreditorit, shumat prej:

i. Shumën që do të përlogaritet nga debitori **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** duke zbatuar me rigorizitet dhe përpikmëri të plotë Vendimin Nr. ... datë ... **05.2019**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, të dhënë me ekzekutim të përkohshëm; dhe

ii. Shpenzimet gjyqësore prej **3,840.00 (tre mijë e tetëqind e dyzet) lekë**; dhe
iii. Tarifën përbarimore që do të llogaritet nga ... pas përlogaritjeve të detyrimit nga debitori që ka ndaj kreditorit (duke përfshirë në tarifën përbarimore dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar) dhe që përfaqëson tarifën fikse, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 385/7, datë 28.06.2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet përbarimore e ofruara nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat" i Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave, seksioni III/2).

- Në total detyroheni të paguani shumën që do të përfshijë totalin e detyrimit, shpenzimet gjyqësore dhe tarifën përbarimore me TVSH bazuar në Vendimin Nr. ... datë ... **05.2019**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

2. Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përbaruesi gjyqësor. (shih nenin 517 paragrafi i dytë të Kodit të Procedurës Civile).

3. Nëse ekzekutimi vullnetar nuk do të ekzekutohet brenda afatit prej **10 (dhjetë)** ditësh nga dita e marrjes dijeni të detyrimit, ndaj palës debitore ... do të fillojë ekzekutimin e detyrueshëm.

4. Për personat që do të bëhen pengesë, do të zbatohet sanksioni i **gjohës deri në shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** në zbatim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, deri në ekzekutimin e detyrimit, si edhe kallëzim penal për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, në zbatim të nenit 320 të Kodit Penal.

5. Derdhja e çdo shume të mësipërme neto, të kryhet detyrimisht pranë ... **Bank (ish Bankës ... Albania), në Numrin e Llogarisë IBAN ...** në ALL (Lek) të shoqërisë përbarimore gjyqësore private ", ... " Sh.p.k.

Shoqëria " ... Sh.p.k.
Përbaruesi Gjyqësor



Bashkangjitur do të gjenti:

- Vendimi Nr. ... datë ... **05.2019**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
GJIROKASTËR

Nr.Regj.Them. ... 2019] Nr. ... VENDIMI
Datë regjistrimi ... 04.2019 Datë ... 05.2019

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë e përbërë nga:

RAMIZ LALA GJYQATAR

Asistuar nga sekretare gjyqësore ... në Gjirokastrë, sot më datë ... 05.2019
shqyrtoi në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative Nr.Regj.Them. ...
2019], datë regjistrimi ... 04.2019, që u përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS: ... i biri i ... dhe ... shtetas shqiptar, lindur më ... 08.1969, në
Dibër, banues në Tiranë me adresë në: Rruga “ ... ”, banesë private; i
identifikuar nga letërnjoftimi me numër personal “ ... ”, me numër
telefonie të lëvizshme “ ... ”

IPADITUR: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me adresë në: Bulevardi
“Bajram Curri”, 1000, Tiranë;

PERSON I INTERESUAR: Shoqëria Përmbarimore Gjyqësore Private “ ... ” Sh.p.k., me
Certifikatë Nr. ... datë ... 02.2011, me NIPT
... dhe adresë në: Rruga “ ... ”, Pallati
... Kati ... Zyra Nr. ... Tiranë, përfaqësuar nga Përfaqësuesi
Ligjor Z. ... (më poshtë referuar si “ ... ”), Z. ...
përmbarues gjyqësor privat pranë ...

OBJEKTI: -Shpalljen të paligjshëm dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit
administrativ të përfaqësuar nga Urdhri Nr. ... datë ... 01.2019 “PËR
TRANSFERIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË NJË PUNONJËSI POLICIE”;
- Detyrimin e të Paditurit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të nxjerrë
aktet nënligjore në zbatim të urdhërimeve të Vendimit Nr. ... Akti, dhe Nr. ...
Vendimi, datë 26.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (në vijim referuar si
“Vendimi ... /2006”); Vendimit Nr. ... datë ... 11.2015 të Gjykatës Kushtetuese,
botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 216 të vitit 2015 (në vijim referuar si “Vendimi
... 2015”), akte të cilat minimalisht por pa u kufizuar duhet të konsistojnë në Aktin
Administrativ:

1- Detyrimin e të Paditurit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të nxjerrë
Aktin Administrativ respektiv për njësimin e gradës, nga “Kryekomisar” në “Drejtuës i
I-rë” në respektim të së drejtës për ecuri në gradë.

1.1. Për efekt të respektimit të të drejtës për ecuri në gradë dhe karrierë, përllogaritja e
kohës së qëndrimit në gradën “Drejtuës i I-rë”, të fillojë nga data ... 12.2007, kur ka
hyrë në fuqi Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 803, datë 21.11.2007 “Për
përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe

(në vijim referuar si "Vendimi ... 2015"); Vendimi Nr. ... Akti, dhe Nr. ... Vendimi, datë ... 12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (në vijim referuar si "Vendimi ... /2006"); Vendimi Nr. ... Akti, datë ... 07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (në vijim referuar si "Urdhri ... /2014"); Ligji 10042, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 4/4 (në vijim referuar si "Ligji 10042/2009"); Vendimi Unifikues Nr. 3, datë 06.12.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; Vendimi Nr. 2/2013; Vendimi Nr. 9/2007 të Gjykatës Kushtetuese; Ligji 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", neni 81/4 (në vijim referuar si "Ligji 8577/2000"); Ligji Nr. 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" (në vijim referuar si "Ligji 8553/1999"); Ligji Nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit" (në vijim referuar si "Ligji 108/2014"; Rregullore e Policisë së Shtetit, miratuar me VKM Nr. 750, datë 16.09.2015, botuar në Fletoren Zyrtare 167 të vitit 2015, veçanërisht neni 179 (në vijim referuar si "VKM 750/2015"); VKM 64, datë 02.02.2001 "Për inkuadrimin e gradave ushtarake në gradat policore dhe përcaktimin e funksioneve që do të ushtrohen sipas tyre" (në vijim referuar si "VKM 64/2001"); VKM 892, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit" (në vijim referuar si "VKM 892/2016").

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat shkresore, si dhe dëgjoi në konkluzione përfundimtare paditësin i cili kërkoi pranimin e kërkesë-padisë, dëgjoi palën e paditur Drejtoria e Policisë së Shtetit përfaqësuar me autorizim nga z. i cili kërkoi rrëzimin e kërkesë-padisë, e si e bisedoi në tërësi çështjen,

VËREN:

Se paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë padinë kundër palës së paditur Drejtoria e Policisë së Shtetit, me objekt: - Shpalljen të paligjshëm dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të përfaqësuar nga Urdhri Nr. ... datë ... 01.2019 "PËR TRANSFERIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË NJË PUNONJËSI POLICIE"; -Detyrimin e të Paditurit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të urdhërimeve të Vendimit Nr. ... Akti, dhe Nr. ... Vendimi, datë ... 12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (në vijim referuar si "Vendimi ... /2006"); Vendimit Nr. ... datë ... 11.2015, të Gjykatës Kushtetuese, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 216 të vitit 2015 (në vijim referuar si "Vendimi ... 2015"), akte të cilat minimalisht por pa u kundërshtuar duhet të konsistojnë në Aktin Administrativ:

- për njësimin e gradës dhe funksionit në respektim të së drejtës për ecuri në gradë dhe karrierë; dhe
- për trajtimin financiar, pagën dhe shtesat mbi të, dhe të drejta të tjera ligjore të lidhura me pagën për gadën korresponduese; dhe
- për njohjen dhe llogaritjen e vjetërsisë në shërbim dhe vjetërsinë për efektivitet të ecurisë në gradë; dhe
- Ngarkimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore, noteriale, përmbarrimore, etj. të Paditurit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit.

*Paditësit, për të gjithë periudhën e pasiguruar, në Policinë e Shtetit; dhe
7- Detyrimi e të Paditurit, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të pastrojë kartelën personale të punonjësit të Policisë së Shtetit, Z. nga aktet administrative absolutisht të pavlefshme, të tillë si ... 2006; ... 2006; ... 2006; ... 2018 dhe ... 2019;
8- Ngarkimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore, noteriale, përmbarimore, etj. të Paditurit, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë Shtetit.*

RRETHANAT E ÇËSHTJES

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore ka rezultuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune pranë palës së paditur fillimisht si Drejtor i Qendrës së Studimit të Kualifikimeve në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari", me gradën Kryekomisar.

Paditësi, për shkak të gradës dhe vendit të punës, paguhej me pagë prej 85.470 (tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë plus 2.000 (dy mijë) lekë vështirësi shërbimi në muaj.

Në bazë të urdhërit nr. ... datë ... 09.2006 të Zv/Ministrit, paditësit i komunikohet emërimi dhe lëvizja nga detyra Drejtor i Qendrës së Studimit të Kualifikimeve në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari" në detyrën e Përgjegjësit në Seksionin e Formimit të Rolit Bazë në të njëjtin institucion.

Më pas urdhërin nr. ... datë ... 09.2006 i Zv/Ministrit të Brendshëm, paditësit për shkak të mospërputhjes së gradës policore me funksionin organik, i caktohet gradë e funksionit "nënkomisar".

Ndryshimi i vendit të punës dhe gradës ka sjellë edhe uljen e pagës së paditësit në 59.940 (pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë në muaj, plus 2.000 (dy mijë) lekë vështirësi shërbimi në muaj.

Paditësi ka kundërshtuar të dy aktet administrative, pra urdhërin nr. ... datë ... 09.2006 dhe urdhërin nr. ... , datë ... 09.2006 të Zv/Ministrit të Rendit Publik, duke konsumuar ankimin administrativ në organin më të lartë hierarkik të Ministrisë së Brendshme, të cilët nuk kanë pranuar ankimin e paditësit, duke e detyruar më pas paditësin të paraqiste padi në gjykatë.

Paditësi i është drejtuar gjykatës me një padi, me anë të së cilës ka kërkuar "Kundërshtimin e Urdhërit nr. ... , datë ... 09.2006, nr. ... , datë ... 09.2006, shfuqizimin si të paligjshëm dhe rivendosjen e të drejtës në funksionin dhe gradën përkatëse".

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ... datë ... 12.2006, ka vendosur:
Pranimin e kërkesë-padisë.

Shpalljen si të pavlefshme të aktit administrativ të përfaqësuar nga Urdhëri ... datë ... 09.2006.

Shpalljen si të pavlefshëm të aktit administrativ të përfaqësuar nga Urdhëri ... datë ... 06.2006.

Detyrimin e të paditurit të rivendosë të drejtat e cenuara në funksionin e mëparshëm si rezultat i pavlefshmërisë së akteve.

Detyrimin e të paditurit të paguaj pagën prej 85.470 (tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë në muaj që i përket gradës Kryekomisar duke filluar që nga data ... 09.2006 e në vazhdim.

Mbi ankimin e palës së tretë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ... datë ... 04.2008, ka ndryshuar vendimin nr. ... datë ... 12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ka rrëzuar padinë si të pabazuar në ligj.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. ... datë ... 04.2019 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. ... datë ... 04.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

me Nr. ... (... 2017), datë ... 09.2017 Regjistrimi, së bashku me aktet bashkëlidhur saj.

Kundër vendimit të mësipërm është ushtruar ankimi i vecantë nga Ministria e Brendshme, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, çështje e cila është në proces gjykim.

Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ndaj Shoqërisë Përbarimore Gjyqësore Private " ... " Sh.p.k., ka bërë kallëzimi Nr. ... Prot., datë ... 04.2017, regjistruar me Nr. ... Prot., datë ... 04.2017 dhe Nr. ... Prot. datë ... 04.2017 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me "Vendimin Për mosfillim procedimi penal" datë ... 07.2017" të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur: "Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. ... te vitit 2017.

Kundër vendimit të mësipërm të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka ushtruar ankim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. ... Regj.Them, datë ... 11.2017, vendosi shfuqizimin e vendimit Nr. ... Prot., datë ... 04.2017 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe urdhërimin e organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të regjistrojë procedimin dhe të kryejë hetimet e nevojshme sipas pjesës arsyetuese të këtij vendimi.

Ndaj Vendimit Nr. ... Regj.Them, datë ... 11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përbarimore gjyqësore private " ... " ka ushtruar ankim.

Gjykatës së Apelit Tiranë, me vendimin Nr. ... datë ... 02.2018 ka vendosur: "Ndryshimin e vendimit nr. ... akti date ... 11.2017 te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane dhe lenien ne fuqi te vendimit te organit te Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Tirane per mosfillimin e procedimit penal nr. ... te vitit 2017.

Ministria e Brendshme me datë ... 03.2018, ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesë padinë e saj, me palë: Paditës: Ministria e Brendshme; I Paditur: ... Përbarimes gjyqësore privat pranë Shoqërisë Përbarimore. ... sh.p.k; Person i Tretë: ... Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Objekti: Kundërshtim veprimesh përbarimore

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me vendimin e ndërmjetëm Nr. Regj. Them. ... datë ... 04.2018 ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me vendimin Nr. ... (2001), datë ... 05.2018 ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesë – padisë. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nëpërmjet Urdhrit Nr. ... datë ... 03.2018, ka vendosur: Rikthimin në policinë e shtetit dhe emërimin në detyrë të zotit ...

Urdheri Nr. ... /2018 i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është kundërshtuar prej paditësit ... pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tij pasi është shprehur në shkelje të hapur administrative, civile dhe penale.

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, u disponua me Vendimin Nr. ... datë ... 05.2018 me të cilin është vendosur:

- "Pranimin e pjesshëm të padisë.
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të aktit administrativ në Tiranë e Urdhrit Nr. ...", datë ... 03.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket referencave të bërë prej tij në lidhje me gradën, vjetërsinë dhe pozicionin e palës të paditësit.
- Rregullimin e pasojave të ardhura nga ky akt administrativ duke detyruar palën e paditur të zbatojë përmes vendimarrjes administrative, parashikimet e vendimeve gjyqësore Nr. ... datë ... 12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është lënë në fuqi me anë të vendimit të Gjykatës së Lartë Nr. ... datë ... 04.2012.

kapërcim të këtyre kompetencave.

Paditësi pretendon se ka nivelin e duhur arsimor profesional për mësimdhënie (pasi ka mbaruar arsimin e lartë Shkolla e Lartë e Ministrisë së Brendshme, cikli 4 vjeçar, me medalje të artë, si është dokumentuar në shqyrtimet e mëparshme gjyqësore, në nivelin master shkencor sipas njëvlerësimeve të nenit 124 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 80/2015 "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", si dhe sudimet në drejtësi deri në nivel master shkencor në të drejtën civile", por, gjatë periudhës së punës në Akademinë e Sigurisë në vitin 2018, është certifikuar në fushën e mësimdhënies në kurset: 1. "Standartet evropiane të kërkimit shkencor dhe botimeve të tyre", Shtator 2018; 2. "Për formimin e instruktorëve", ...10.2018 deri ...10.2018; 3. "Për trajnimin e trajnerëve për mësimdhënie në qendrën e trajnimit privat" ...12- ...12.2018.

Paditësi pretendon se, akti administrativ, Urdhri .../2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së shtetit, ka mangësi në elementët e domosdoshëm materialë dhe proceduralë, për realizimin e qëllimit për të cilin është nxjerrë, duke e bërë atë, akt të paligjshëm dhe absolutisht të pavlefshëm në referencë të neneve 108 dhe 109 të Ligjit Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë:

Paditësi pretendon se akti administrative objekt gjykimi, Urdhri ... 2019, është nxjerrë në vijim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr. ... datë ...03.2018 "Për rikthimin në policinë e shtetit dhe emërimin në detyrë të zotit , dhe ka për referencë po atë gradë "Kryekomisar" dhe po atë funksion "Shef Sektori, në Sektorin e Trajnimeve dhe Mjeteve Motorrike, në Drejtorinë e Certifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të tretëve, në Akademinë e Sigurisë", i gjetur pjesërisht absolutisht i pavlefshëm me Vendimin Nr. ... datë ... 05.2018 Gjykates Administrative të Shkalles së Parë Tirane, të cituar më sipër. Edhe në këtë këndvështrim detyrimisht rezulton se Urdhri ... 2019, është absolutisht i pavlefshëm në referencë të nenit 110 të Ligjit Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Paditësi pretendon se, Urdhri .../2019, është nxjerrë në kundërshtim të hapur e në moszbatim/ekzekutim me Vendimin Nr. ... Akti, dhe Nr. ... Vendimi, datë ... 12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimin Nr. ... Akti, datë ... 07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimin Nr. ... datë ... 11.2015, të Gjykatës Kushtetuese, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 216 të vitit 2015. Vendimi ... i vitit 2006, shpalli të pavlefshëm Urdhrin ... , datë ...09.2006, pasi detyroi të paditurin, Ministria e Brendshme, dhe të paditurin/Personin e Tretë, Drejtorinë e Policisë së Shtetit, të rivendosë të drejtat në gradën e mëparshme, Kryekomisar, të parashikuar në VKM 64/2001 "Për inkuadrimin e gradave ushtarake në grada policore dhe përcaktimin e funksioneve që do të ushtrohen sipas tyre", e cila nuk ka asnjë lidhje me përcaktimin e hierarkisë policore dhe masës së pagës me gradën "kryekomisar" të cilës i referohet akti administrativ, Urdhri ... 2019, pavarësisht emërimit të njëjtë.

Paditësi, sqaron se ndër vite përcaktimi i gradës "Kryekomisar" ka ndryshuar me disa vendime të tjera të Këshillit të Ministrave, me VKM 803, datë 21.11.2007 "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre", VKM 917, datë 04.10.2013, dhe së fundmi me VKM 892/2016, ku grada "Kryekomisar" është ekuivalentuar me gradën "Drejtnes i Parë" në raport me funksionin. Edhe sipas konceptit ligjor ku grada përcaktohet si shprehje e hierarkisë dhe nivelit është lehtësisht e dallueshme diferenca mes gradës "Kryekomisar" e cila sipas VKM 64/2001, ishte grada më e lartë e rolit të lartë drejtues në Policinë e Shtetit e barasvlefshme me gradën "Drejtnes i Parë" apo "Drejtnes i Lartë", me gradën "kryekomisar" të përmendur në Urdhrin .../2019, e cila i referohet nivelit të mesëm drejtues, e barasvlefshme me gradën "kryeinspektor" sipas VKM 64/2001, për rrjedhojë akti administrativ, Urdhri ... 2019, jo vetëm nuk ka lidhje me Vendimin ... të vitit 2006, ekzekutueshmërinë e Urdhrit të Ekzekutimit ... 2014, Vendimin ... 2015, por *de facto* vijon të imponojë uljen në funksion dhe në gradë për rrjedhojë në pagë edhe më poshtë sesa vetë aktet administrative të shpallura të pavlefshme,

"Pranimin e kërkesës. Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. ... datë ... 12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ..."

Paditësi pretendon se është krejtësisht e qartë se Urdhri ... 2019, nuk rivendos të drejta, por i mohon dhe shkel në mënyrë flagrante ato, duke moszbatuar/ekzekutuar vendimet e gjykatës, sjellje e organit të administratës publike që përbën vepër penale, e në këtë këndvështrim edhe zbatimi i mëtejshëm i Urdhrit ... 2019 do të përbente vepër penale. Për sa më sipër paditësi kërkon pranimin e kërkesë padisë.

Pretendimet e palës së paditur.

Urdhëri nr. ... datë ... 01.2019 "Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie është një akt administrativ i nxjerrë në respektim të plotë të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" të ndryshuar, në Rregulloren e Policisë së Shtetit si dhe në Memon e Akademisë së Sigurisë nr. ... datë ... 01.2019 "Mbi personelin akademik në Akademinë e Sigurisë i cili nuk plotëson kriteret për mësimdhënie, në zbatim të rregullores së Akademisë së Sigurisë dhe të rregulloreve të Njësive Kryesore".

Përsa më sipër, referon, pala e paditur, pretendon se i është në përfundim se Urdhëri nr. ... datë ... 01.2019 është një akt i nxjerrë tërësisht i mbështetur në Ligjin nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".

Lidhur me "Memon" e Akademisë së Sigurisë nr. ... datë ... 01.2019 "Mbi personelin akademik në Akademinë e Sigurisë i cili nuk plotëson kriteret për mësimdhënie, në zbatim të rregullores së Akademisë së Sigurisë dhe të rregulloreve të Njësive Kryesore" është vlerësimi i bërë nga Akademia e Sigurisë e cila ka arritur në përfundim se paditësi nuk plotëson kriteret për mësimdhënie.

Ky vlerësim i dhënë nga Akademia e Sigurisë dhe nevoja e punës pikërisht në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Gjyrokastër ligjërojnë vendimmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për nxjerrjen e Urdhërit nr. ... datë ... 01.2019. Sikurse dhe vetë paditësi është referuar Ligji nr. 44/2015 "Kodin e Procedurave Administrative" Pala e paditur pretendon se verimet e saj janë tërësisht të mbështetura në Ligj lidhur me kompetencën, procedurën dhe ligjshmërinë.

Përsa i përket kërkimeve të tjera të bëra në padinë objekt gjykimi dhe respektivisht në pikën 1, 1.1, .1, 2, 3,4,5,6,7 pala e paditur prapëson si më poshtë: Me Vendimin nr. ...

datë ... 05.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjyqtar ... është vendosur: Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të përfaqësuar nga Urdhëri nr. ... datë ... 03.2018 "për rikthimin në Policinë e Shtetit dhe emërimin në detyrë të z. ...". Detyrimin e të paditurit, Drejtoria e Policisë së Shtetit do të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të urdhërimeve të Vendimit nr. ... Akti dhe ... datë ... 12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimit nr. ... datë ... 11.2015 të Gjykatës Kushtetuese, akte të cilat minimalisht por pa u kufizuar duhet të konstatojnë në aktin administrativ për njehsimin e gradës dhe funksionit në respektim të së drejtës për ecuri në gradë dhe karrierë dhe aktin administrativ për trajtim financiar, pagesën shtesat mbi të dhe të drejtat të tjera të lidhura me pagat dhe aktin administrativ për njohjen dhe likuidimin e detyrimeve për sigurimin shoqërorë e suplementar dhe Aktin administrativ për njohjen dhe llogaritjen e vjetërsin në shërbim dhe vjetërsinë për efekt të ecurisë në gradë dhe Sigurimin e padisë nëpërmjet pezullimit të aktit administrativ të përfaqësuar nga Urdhëri nr. ... datë ... 03.2018. "Për rikthimin në Policinë e Shtetit dhe emërimin në detyrë të z. ... si dhe të efekteve të tij juridike ligjore apo efekteve të tjera administrative të lidhura me të deri në përfundim të gjykimit. Ngarkimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore, noteriale, përmbartimore etj të pëditurit, Drejtoria e Policisë së Shtetit". Duke ju referuar këtij Vendimi, objektit të padisë mbi të cilën ka dispozuar ky vendim, del lehtësisht e qartë se kërkimet e bëra në atë gjykim dhe kërkimet në këtë padi objekt gjykimi janë të njëjta. (duke përjashtuar pikën e parë të objektit të padisë). Përsa më lart një Gjykatë në Republikën e Shqipërisë i ka gjykuar këto kërkime dhe është shprehur me

nenin 41 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit".

4. Ministri i Brendshëm merr masa për përfundimin e procesit të kalimit në sistemin e ri të gradave, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 126 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe në këtë vendim, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Zbatimi i këtij vendimi nuk passjell efekte financiare në Buxhetin e Shtetit.

6. Vendimi nr.64, datë 2.2.2001 i Këshillit të Ministrave "Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit, dhe për përcaktimin e funksioneve, që do të ushtrohen sipas tyre", të ndryshuar, nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit.

Neni 108 i K.Pr.Administrative

Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm

Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjisllacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose

iii) formën ose elementët të tjerë të detyrueshëm të aktit;

b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;

c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjisllacionit penal;

c) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

Neni 109 i K.Pr.Administrative

Paligjshmëria e aktit administrativ

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;

b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;

c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;

c) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;

d) është në kundërshtim me ligjin material;

dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo

e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

ANALIZA LIGJORE

Së pari: Gjykata, në interpretim të dispozitave të mësipërme ligjore, të provave të paraqitura për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe të deklarimeve të palëve të dhëna në seancë gjyqësore, vlerëson të ndalet në përcaktimin e saktë të marrëdhënies juridike që është krijuar mes palëve ndër-gjyqësore e në vijim dhe në ligjin material dispozitat e të cilit normojnë marrëdhënien në konflikt gjyqësor. Qëndrimi i gjykatës bazohet dhe në qëndrimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë se *"...gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, por nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar..."* (Vendim nr.3, datë 29.03.2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).

Sipas objektit dhe përmbajtjes së padisë, gjykata çmon se kemi të bëjmë me kërkimin për paligjshmëri të aktit administrative, urdhërit nr. ... datë ...01.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit "Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie"; Detyrimin e organit administrativ Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i njohë paditësit Gradën Policore Drejtues i I-rë, ta rikthejë në vendin e punës që i korrespondon grada policore Drejtues i I-rë si dhe pagaimin e pagës, vjetërsisë në punë, pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe sigurimin për pension suplementar mbi bazën e pagës që i korrespondon gradës policore Drejtues i I-rë.

Së dyti: në lidhje me jurisdiksonin gjyqësor.

Gjykata bazuar në dispozitat ligjore të ligjit të posaçëm për Policinë e Shtetit, çmon se

me gradën "Inspektor" në funksione, të cilat janë brenda juridiksionit të tyre, me kusht që funksioni të mos ketë gradë më të ulët se ajo që mban punonjësi.

4. Transferimi i punonjësit të policisë me gradën "Nënkomisar" deri në "Drejtnes i parë", si dhe të gjitha transferimet e punonjësve nga një strukturë në një strukturë tjetër, pavarësisht nga grada, bëhen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

5. Punonjësi i policisë nuk transferohet nëse nuk ka plotësuar afatin minimal prej 2 vjetësh të qëndrimit në detyrë, me përjashtim të rasteve të veçanta, të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

6. Në çdo rast, transferimi i punonjësit të Policisë së Shtetit bëhet me vendim të motivuar dhe i komunikohet personit të transferuar.

7. Rregullat dhe procedurat e transferimit përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 180 i Rregullores mbi policinë e shtetit përcakton:

Rastet e transferimit të punonjësit të policisë

1. Punonjësi i policisë mund të transferohet dhe të emërohet në detyrë në çdo strukturë të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën që ka.

2. Transferimi mund të bëhet në rastet e mëposhtme:

a) me kërkesën e punonjësit të policisë;

b) për nevoja të punës;

c) për fitimin e gradës;

d) kur shkurtohet funksioni organik në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë;

e) kur ekziston një situatë reale dhe e rrezikshme ndaj jetës dhe familjes së punonjësit të policisë;

dh) kur punonjësi i policisë nuk arrin nivelin e nevojshëm të kryerjes së detyrave në funksionin që mban;

e) për ndryshim të statusit të funksionit;

ë) për arsye shëndetësore dhe familjare.

Në seancë gjyqësore u provua se, pala e paditur Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me Urdhërin Nr. ... date ... 03.2018 "Per rikthimin ne policine e shtetit dhe emerimin ne detyre te zotit ... ka vendosur: 1. Zoti ... ish punonjës policie, liruar nga policia e shtetit me motivacionin "Për shkurtim të funksionit organik", në zbatim të vendimeve gjyqësore për pavlefshmërinë e aktit administrativ/ urdhërit nr. ... datë ... 09.2006 dhe detyrimin e rivendosjes së të drejtave të cenuara në funksionin e mëparshëm, të rikthehet në policinë e shtetit dhe të emërohet në detyrën Shef sektori, në Sektorin e Trajnimeve dhe Mjeteve Motorrike, në Drejtorinë e Certifikimeve dhe shërbimeve ndaj të Tretëve, në Akademinë e Sigurisë. 2. Ti jepet grada policore "Kryekomisar". 3. Të drejtat Finaciare fillojnë më datë ... 03.2018.

Gjykata nisur nga koha e riemërimit të paditësit në strukturat e Policisë së Shtetit në referim të dispozitave ligjore të mësipërme, çmon se akti administrativ urdhëri Nr. ... datë ... 01.2019 i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material mbi Policinë e Shtetit.

Akti administrativ, urdhëri Nr. ... datë ... 01.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është nxjerrë në kundërshtim me pikën 5 të nenit 43 të Ligjit Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", sipas të cilës "5. Punonjësi i policisë nuk transferohet nëse nuk ka plotësuar afatin minimal prej 2 vjetësh të qëndrimit në detyrë, me përjashtim të rasteve të veçanta, të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit."

Sa sipër u provua se paditësi në kohën e transferimit nëpërmjet urdhërit objekti i kërkesës gjyqësore nuk ka patur të plotësuar kushtin 2 vjet në mënyrë që ai të mund të transferohej.

Pala e paditur nuk paraqiti aktin administrativ të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit mbi ekzistencën e rasteve të veçanta të transferimit dhe se në këtë akt të përfshihej dhe transferimi i paditësit.

Pala e paditur në kundërshtim me pikën 2 të nenit 180 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM 750/2015, ka bërë transferimin e paditësit.

Transferimi i paditësit është bërë pa kërkesë të paditësit. Pala e paditur nuk provoi se transferimi i paditësit është bërë për nevoja pune. Transferimi i paditësit nuk është bërë për shkak të fitimit të gradës policore të urdhëruar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Nuk ekziston shkurtime funksionit organik në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë. Nuk ekziston një situatë reale dhe e rrezikshme ndaj jetës dhe familjes së punonjësit të policisë, z. ... Transferimi i paditësit nuk është bërë për ndryshim të statusit të funksionit. Transferimi i paditësit nuk është bërë për arsye shëndetësore dhe familjare.

nevojshme, të parashikuara nga ligji nr.8643, datë 20.7.2000, këtë gradë e ruan deri në tri vjet, nga çasti i dhënies së saj, periudhë gjatë së cilës duhet të kryejë kursin e kualifikimit, prej 24-javësh.

VKM-ja nr.803 datë 21.11.2007 "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për Gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre" parashikon se;

1. Funksionet korresponduese, për çdo gradë, sipas ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", si dhe ekuivalentimi i tyre me gradat e marra, sipas ligjit nr.9643, datë 20.7.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit", përcaktohen në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në funksionet e këshilltarit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, oficerit ndërlihdës ose pranë organizmave policore ndërkombëtare, mund të caktohet çdo punonjës policie, pavarësisht gradës, që mban. Gjatë periudhës në këto funksione, punonjësi i policisë ka të drejtë të fitojë gradën pasardhëse, sipas kritereve e procedurave të përcaktuara, i pakushtëzuar nga ekzistenca e funksioneve të ltra për gradë.

3. Punonjësi personel i policisë merr gradën, që i korrespondon funksionit që kryen, vetëm nëse në çastin e kalimit në këtë sistem gradash, ka vjetërsi shërbimi jo më pak se:

a) 1 vit e 4 muaj për gradën "Inspektor", përfshirë edhe periudhën e shkollimit policor, me përjashtim të punonjësve të policisë, që janë në periudhën e provës;

b) 2 vjet e 8 muaj për gradën "Kryeinspektor";

c) 4 vjet për gradën "Nënkomisar", përfshirë edhe periudhën e shkollimit policor. Specialistëve të lartë të policisë në detyrë, u jepet grada "Nënkomisar" edhe, nëse nga përlllogaritja nuk plotësojnë vjetërsinë e shërbimit, përcaktuar në këtë shkronjë;

c) 6 vjet për gradën "Komisar";

d) 8 vjet për gradën "Kryekomisar";

dh) 10 vjet për gradën "Drejtuës";

e) 12 vjet e 8 muaj për gradën "Drejtuës i parë";

ë) 15 vjet e 4 muaj për gradën "Zëvendësrejtör i Përgjithshëm".

3/1 Pas kalimit në sistemin e ri të gradave, ngritja në gradë bëhet sipas afateve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 41 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit".

4. Ministri i Brendshëm merr masa për përfundimin e procesit të kalimit në sistemin e ri të gradave, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 126 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe në këtë vendim, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Zbatimi i këtij vendimi nuk pasqjell efekte financiare në Buxhetin e Shtetit.

6. Vendimi nr.64, datë 2.2.2001 i Këshillit të Ministrave "Për inkadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit, dhe për përcaktimin e funksioneve, që do të ushtrohen sipas tyre" të ndryshuar, nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit.

Sipas lidhjes I "Tabela e Ekuivalentimit dhe e Funksioneve Korresponduese për çdo gradë", që i bashkëlidhet VKM nr.803 datë 21.11.2007 "Për Përcaktimin e funksioneve Korresponduese për Gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre" përcakton Grada ekuivalente Kryekomisar është Drejtues i Parë.

Përcaktimi i gradës "Kryekomisar" ka ndryshuar me disa vendime të tjera të Këshillit të Ministrave, me VKM 803, datë 21.11.2007 "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre", VKM 917, datë 04.10.2013, dhe së fundmi me VKM 892/2016, ku grada "Kryekomisar" është ekuivalentuar me gradën "Drejtuës i Parë" në raport me funksionin. Sipas parashikimeve ligjore e nënligjore grada përcaktohet si shprehje e hierarkisë dhe nivelit është lehtësisht e dallueshme diferenca mes gradës "Kryekomisar" e cila sipas VKM 64/2001, që ishte grada më e lartë e rolit të lartë drejtues në Policinë e Shtetit ndërkohë që aktualisht është e barasvlershme me gradën "Drejtuës i Parë" apo "Drejtuës i Lartë".

Sa sipër gjykata cmon se duhet të detyrohet pala e paditur t'i njohë paditësit gradën policore Drejtues i I-rë.

Gjykata cmon se duhet të detyrohet pala e paditur t'i njohë gradën policore Drejtues i Parë që në datën e hyrjes në fuqi të VKM 803, date 21.11.2007 "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre", datë 27.12.2007.

Gjykata e gjen të pabazuar në ligji kërkimet e paditësit për përlllogaritjen e kohës së qëndrimit në gradë drejtues i I-rë, nga data 27.12.2007. VKM 803, date 21.11.2007 "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre" është botuar në fletore zyrtare më datë 11.12.2007 ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të saj. Ky akt ka hyrë në fuqi më datë 27.12.2007.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur:

- "Pranimin e pjesshëm të padisë.
 - Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të aktit administrativ në trajtën e Urdhrit Nr. ... datë ... 03.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, përsa i përket referencave të bërë prej tij në lidhje me gradën, vjetërsinë dhe pozicionin e punës të paditësit.
 - Rregullimin e pasojave të ardhura nga ky akt administrativ duke detyruar palën e paditur të zbatojë përmes vendimarrjes administrative, parashikimet e vendimeve gjyqësore Nr. ... datë ... 12.2006 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është lënë në fuqi me anë të vendimit të Gjykatës së Lartë Nr. ... datë ... 04.2012.
 - Rrëzimin e padisë përsa i përket pjesës tjetër të kërimit si të pabazuar në ligj.
 - Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe në çastin kur merret formë të prerë, ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Zyrat e Përmbarrimit në Republikën e Shqipërisë.
- Kundër vendimit të mësipërm është ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, çështje e cila është në shqyrtim pranë kësaj gjykate.

Nga vërtet pamja e objektit të kërkesë padisë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe atij nëpërmjet të cilit Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka disponuar nëpërmjet vendimit datë ... 05.2018 rezultojnë se këta objekte nuk janë të njëjtë.

Pala e paditur pas dhënies së vendimit të mësipërm gjyqësor nga Gjykata Administrative ka disponuar me urdhërin objekt shqyrtimi gjyqësor për transferimin e paditësit.

Kërkimi i paditësit në çështjen gjyqësore të mësipërme ka të bëjë me rregullimin e pasojave për shkak të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ Urdhrit Nr. ... datë ... 03.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Pala paditëse nëpërmjet kërimit objekt shqyrtimi gjyqësor kërkon shfuqizimin e urdhërit nr. ... datë ... 01.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit "Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie"; Detyrimin e organit administrative Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ti njohë paditësit Gradën Policore Drejtues i I-rë nga data e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor VKM Nr.893/2007, ta rikthejë në vendin e punës që i korrespondon gradë policore Drejtues i I-rë si dhe pagësimin e pagës, vjetërsisë në punë, pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe sigurimin për pension suplementarë mbi bazën e pagës që i korrespondon gradës policore Drejtues i I-rë, nga data e lindjes së të drejtës.

Si përfundim gjykata bazuar në nenet 6, 10, 12, 14, 16, 20, 28, 29 dhe 31 të Kodit të Procedurës Civile, duke i bërë një cilësim të saktë fakteve dhe të veprimeve që lidhen me këtë mosmarrëveshje, në analizë të provave shkresore të paraqitura nga palët, si dhe në vështrim të dispozitave të ligjit material "Për Policinë e Shtetit" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, konkludon pjesërisht të bazuar në ligj dhe në prova kërkesë padinë e paditësit dhe për këtë fakt duhet të vendosë pranimin e kërkesë - padisë : Shfuqizimin e aktit administrative, urdhërit Nr. ... datë ... 01.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit "Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie". Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit: - t'i njohë paditësit gradën policore Drejtues i I-rë nga data ... 12.2007 e në vazhdim. - t'i paguajë paditësit pagën e pamarrë si Drejtues i I-rë nga data ... 07.2008 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i I-rë. - t'i njohë dhe paguajë paditësit vjetërsinë në punë si drejtues i I-rë nga data ... 12.2007 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i I-rë. - t'i paguajë paditësit sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe sigurimin suplementarë në bazë të pagës që i korrespondon gradës policore Drejtues i I-rë nga data ... 12.2007 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon gradës policore Drejtues i I-rë.

Në lidhje me kërkimin e paditësit për dhënien e vendimit në ekzekutim të përkohshëm Sipas nenit 317 të KPRC parashikohet se: "Vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur:

8. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
9. Vendimi i gjykatës përbën titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor në mënyrë të menjëhershme dhe të përkohshme për të drejtat e përfituara nga subjekti paditës nëpërmjet këtij vendimi gjyqësor nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqëse.
10. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.


U shpall në Gjirokastrë, sot më datë 05.2019.

SEKRETARE



GJYQTARI

RAMIZ LALA



Shpenzimet gjyqësore

Taksë regjistrimi kërkesë padie	3000 Lekë
Shpenzime për njoftime	7 njoftime x 120 = 840 (të papaguara)
Gjithësej	3840 Lekë